



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	22.09.2025
REFERENC-Ë:	25/4875/MMPHI
PËR/Z.A/TO:	"Floris Dorian" Sh.p.k, Istog
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/4875/358/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në draft vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

- Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Floris Dorian" Sh.p.k, Istog për Implantin për asgjësimin e mbeturinave spitalore në Istog në ngastrën kadastrale Nr. P-70806044-00897-2 në ZK Sinajë, Komuna Istog.
- Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31, pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure


Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Kompanisë "Floris Dorian" Sh.p.k, Istog, i Lëshohet Pëlqimi Mjedisor, për Implantin për asgjësimin e mbeturinave spitalore në Istog në ngastrën kadastrale Nr. P-70806044-00897-2 në ZK Sinajë, Komuna Istog, nën kushtet si vijon:

- Të trajtohen vetëm mbeturina spitalore që klasifikohen si të djegshme, sipas kodeve të katalogut evropian të mbeturinave (EWC).
- Të përjashtohen kategorikisht:
 - Mbeturina radioaktive
 - Mbeturina citotoksike ose farmaceutike shumë të rrezikshme, nëse nuk ka teknologji të dedikuara



- Operatorët duhet të kenë kontrata me prodhues të licencuar të mbeturinave spitalore, si: spitale, klinika, laboratorë, qendra veterinare.
- Të organizohet një pikë kontrolli të mbeturinave në pranim, me sistem identifikimi dhe regjistrimi të sasisë, llojit dhe origjinës.
- Të verifikohet përputhshmëria me lëndën e lejuar për asgjësim.
- Të refuzohen ngarkesat që përmbajnë lëndë jo të përshtatshme ose të paidentifikuara
- Të ndërtohet zonë e veçantë për ruajtje të përkohshme të mbeturinave, e venteluar, e mbyllur dhe me kontroll të temperaturës.
- Koha maksimale e ruajtjes së mbeturinave në objekt: jo më shumë se 48 orë, për të parandaluar dekompozimin.
- Sipërfaqja të jetë e papërshkueshme nga lëngjet, me sistem mbledhjeje të ujërave të ndotura.
- Të implementohet sistem për pastrimin e gazrave të djegies, që përfshin:
 - Filtra HEPA ose elektrostatikë
 - Sisteme për neutralizimin e acideve (HCl, HF, SO₂)
 - Reduktim të NO_x dhe PCDD/F (dioksina/furane)
- Të kryhet monitorim i vazhdueshëm për këto ndotës:
 - CO, NO_x, HCl, SO₂, pluhur, Hg, Cd, Pb, PCDD/F
- Vlerat kufitare të emisioneve duhet të jenë në përputhje me Direktivën 2010/75/BE (IED) dhe UA-të vendore për emisionet.
- Hiri dhe skori të klasifikohen si mbetje të rrezikshme dhe:
 - Të ruhen në kontejnerë të mbyllur
 - Të karakterizohen për rrezikshmëri dhe të dërgohen për asgjësim në objekte të licencuara jashtë vendit (nëse nuk ka kapacitete lokale)
 - Të mbahet regjistër për sasinë dhe mënyrën e asgjësimit të tyre.
- Impianti të pajiset me sistem për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave teknologjike, duke përfshirë:
 - Kondensatet nga sistemi i pastrimit të gazrave
 - Ujëra nga larja e makinave transportuese
- Të ndalohet shkarkimi direkt në rrjetin e ujërave pa trajtim paraprak.
- Të sigurohet që **niveli i zhurmës** të mos e kalojë kufirin e lejuar për zonën përkatëse, sipas UA për cilësinë akustike.
- Të zbatohet një plan i **veprimit emergjent** për:
 - Zjarr
 - Shpërthim
 - Derdhje të rrezikshme biologjike ose kimike
- Operatorit i kërkohet të paraqesë raporte vjetore për:
 - Sasinë e mbeturinave të djegura
 - Emisionet në ajër
 - Mbetjet e mbetura nga procesi

- Ujërat e trajtuara
- Të kryhen analiza laboratorike në institucione të akredituara.
- Në rast të mbylljes së impiantit, operatori duhet të:
 - Paraqesë plan për **rehabilitimin e zonës**
 - Të largojë mbeturinat, substancat dhe pajisjet ndotëse
 - Të demonstrojë që nuk ka rrezik të mbetur për mjedisin
- Bazuar në Ligjin e Ujrave Nr.04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.

Aplikuesi përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartëcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

A r s y e t i m


Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga Kompania "Floris Dorian" Sh.p.k., Istog, për Pëlqim Mjedisor për Impiantin për asgjësimin e mbeturinave spitalore në Istog në ngastrën kadastrale Nr. P-70806044-00897-2 në ZK Sinajë, Komuna Istog, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/4875/ ZSP/ /25 datë: 22.09.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. *Parashtruesit të kërkesës*
2. *Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit*
3. *Komisionit për VNM*
4. *Inspektoratit*
5. *Kabinetit të Ministrit*
6. *Komunës së Istogut*
7. *Divizionit për komunikim me publikun*
8. *Arkivit të MMPHI*

Izedin Bytyqi

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI



2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.